




Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Pushtetit Lokal

Ministarstvo Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government



| | | |
|----------------------|--|-----------------------------------|
| Për: | Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës së Prishtinës Agim Kuleta, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prishtinës | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | Goran Rakić, Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MPL-së | |
| Nga: | Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave | Datë: 12.06.2020 Nr.020-264 |
| Zyrtaret përgjegjës: | 1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor i Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor i Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave | |
| Lënda: | Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Prishtinës | |
| Lloji i aktit: | <input type="checkbox"/> Vendim i Kuvendit të Komunës | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|--|
| Vendimi i Kuvendit të Komunës Nr. 01-463/01-58576/20 për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Salih Grajqevci, Gani Azemi, Avni Azemaj, Adnan Maxhuni, Gent Azemaj dhe Alban Beci |
| I miratuar më datë: 10.03.2020 |
| I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 13.03.2020 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Pushtetit Lokal

Ministarstvo Lokalne Uprave

Ministry of Local Government



| | |
|---|---|
| Za: | Shpend Ahmeti, gradonačelnik Opštine Priština Agim Kuleta, predsedavajući Skupštine opštine Priština |
| Kopija: | Jedinici za administraciju dokumenata u MLU Jedinici za administraciju dokumenata u opštini |
| Preko: | Goran Rakić, zamenik premijera i ministar MLU-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MLU-a |
| Od: | Venera Çerkini, rukovodilac Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MLU |
| Službenik-ca za utvrđivanje pravne procene: | Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština |
| Službenik-ca za izradu pravne procene: | Vjosa Ahmetaj, službenica za monitorisanje opština |
| Predmet: | Potvrda zakonitosti akta Skupštine opštine Priština |
| Vrsta akta: | Odluka Skupštine opštine |

Uvaženi gradonačleniče,

Uvaženi predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 o administrativnom razmatranju akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MLS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka skupštine opštine br. 01-463/01-58576/20 o razmeni nepokretne imovine opštine sa nepokretnom imovinom u vlasništvu sledećih vlasnika: Salih Grajqevci, Gani Azemi, Avni Azemaj, Adnan Maxhuni, Gent Azemaj i Alban Beci

Usvojena dana, 10.03.2020.

Predložena na razmatranje u MLU dana, 13.03.2020.

Ministarstvo lokalne uprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da opštinski akt iz proceduralnog aspekta u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav ne može proizvesti pravni efekat. Ministarstvo lokalne uprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Prishtina – Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d e Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe nenit 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunesë, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 34.1, shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 10-391, të dt. 25.02.2010.

Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më



V E N D I M

- I. MIRATOHET propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Salih Grajqevci, Gani Azemi, Avni Azemaj, Adnan Maxhuni, Gent Azemaj dhe Alban Beci.
- II. Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesë e parcelës kadastrale nr. 02955-7, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-02955-7, Zona kadastrale Prishtinë, kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, është pjesë e parcelës kadastrale nr. 07179-1, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-07179-1, Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi të pronarëve Salih Grajqevci, Gani Azemi, Avni Azemaj, Adnan Maxhuni, Gent Azemaj dhe Alban Beci.
- III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë, pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues "Arbëria 3".
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastrale të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.

VIII. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë:

- skica grafike,
- kopjet e planit dhe
- certifikatat e njësisë kadastrale.

IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/01-58576/20 , më 11.03.2020

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

PRISHTINA

| | | | |
|---|-------------|------------|-------|
| HYRËSE-ULAZIMORING REPUBLICAN E KOSOVES REPUBLICAN OF KOSOVA GEVRIJA E KOSOVES VLADARISHTIA E KOSOVES | | | |
| Ministria e Administrimit Lokalit Lokal Ministerstvo Lokalne Samouprave Administracione Ministry of Local Government Administration | | | |
| Data Datum Date | | 13.03.2020 | |
| Titulli organizator | Nr i Lëndës | Shtojca | Vendi |
| -VI- | 020-264 | | |

Na osnovu odredbe člana 12, stav 12.2, slovo d, Zakona br. 03/L-040, o lokalnoj samoupravi ("Službeni List Republike Kosova", br. 28/15, juni 2008), član 24, stav 1, 2 i član 25, stav 1,2 i član 6 Zakona br. 06/L-092, za davanje na korišćenje i izmenu nepokretne imovine Opštine ("Službeni Liste Republike Kosova", br. 10/03, april 2019 god.), i člana 33.2, slovo a, i člana 34.1, slovo d, Statuta Opštine Priština, 01. br. 110-391, dana 25.02.2010 god. Skupština Opštine Priština, na sednici održanoj dana 10.03.2020 god. donosi sledeću

ODLUKA

- I. **USVAJA SE** predlog Predsednika Opštine za izmenu nepokretne imovine opštine sa nepokretnom imovinom u vlasništvu Salih Grajqevci, Gani Azemi, Avni Azemaj, Adnan Maxhuni, Gent Azemaj i Alban Beci.
- II. Nepokretna imovina opštine koja će se dati za izmenu, ima ove karakteristike: deo katastarske parcele br. 02955-7, sertifikat imovine, br. P-71914059-02955-7, Katastarska zona Priština, dok nepokretna imovina koja se uzima iz ove izmene je deo katastarske parcele br. 07179-1, Sertifikat imovine br. P-71914059-07179-1, Katastarska zona Priština, u vlasništvu vlasnik Salih Grajqevci, Gani Azemi, Avni Azemaj, Adnan Maxhuni, Gent Azemaj i Alban Beci.
- III. Izmena nepokretne imovine je izvršena zato što ne postoje druge opštinske pogodne parcele za realizaciju regulativnog Plana "Arbëria 3".
- IV. Pre javnog objavljivanja odluke, biće izvršena kvalifikovana procena tržišne vrednosti nepokretne imovine Opštine i procena privatne svojine, gde će se odrediti tacne površine za izmenu.
- V. Način i uslovi razmene nepokretne imovine biće određeni ugovorom, koja se vezuje i potpisuje između Predsednika Opštine i vlasnika katastarske parcele koja će se izmeniti.
- VI. Nepokretne imovine opštine koja će se izmeniti, opisane u tačku II ove odluke, treba evidentirati u katastarskim knjigama Opštine.
- VII. Za sprovođenje ove odluke stara se: Predsednik Opštine, Direkcija za Imovinu i Direkcija za Katastar Opštine Prištine.

VIII. Sastavni deo ove odluke su :

- grafičke skice,
- kopije plana i
- certifikat katastarske jedinice.

IX. Ova odluka stupa na snagu 15 dana nakon registracije u Kancelariju protokola Ministarstva Lokalne Samouprave i objavljivanja na službenim jezicima na veb stranici Opštine.

SKUPŠTINA OPŠTINA PRIŠTINE
01-463/01-58576/20, dana 11.03.2020

PRESEDAVAJUĆI SKUPŠTINE
Agim Kuleta





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

KOMUNA E PRISHTINËS

Kryetari i Komunës

01.nr. _____, më _____

Në bazë të dispozitave të nenit 58, shkronja **h**, e Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), i Ligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019) dhe të nenit 52, shkronja **h** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, në cilësinë e Kryetarit të Komunës së Prishtinës, më _____, i

PROPOZOJ

- I. Kuvendit të Komunës, miratimin e Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në bashkëpronësi të Salih Grajqevcit, Gani Azemit, Avni Azemajt, Adnan Maxhunit, Gent Azemajt dhe Alban Becit.
- II. Propozimi i cekur në pikën I të këtij propozimi, nënkupton këmbimin e:
 1. Sipërfaqes prej 22 m², pjesë e parcelës kadastrale nr. 2955-7, me sipërfaqe prej 2139 m² në pronësi të PSHKK Prishtinë, ZK Prishtinë, me:
 2. Pronën e paluajtshme në bashkëpronësi të Salih Grajqevcit, Gani Azemit, Avni Azemajt, Adnan Maxhunit, Gent Azemajt dhe Alban Becit, me sipërfaqe prej 22 m², pjesë e parcelës kadastrale 7179-1, Zona kadastrale Prishtinë.
- III. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private.
- IV. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të këtyre parcelave do të rregullohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesve të parcelave të parapara për këmbim.
- V. Pjesë përbërëse e këtij propozimi është edhe skica gjeodezike.
- VI. Ky propozim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

Arsyetim

Drejtoria e Urbanizmit në bazë të Vendimit për përcaktimin e kushteve ndërtimore, 05 nr. 350/02-0299521/18, dt. 11.06.2019, ka dhënë Pëlqimin për këmbimin e pjesës së parcelës kadastrale nr. 2955-7, me sipërfaqe 22 m², në pronësi PSH, rrugë, KK Prishtinë, me pjesën e parcelës kadastrale nr. 7179-1, me sipërfaqe prej 22 m², ZK Prishtinë, në bashkëpronësi të Salih Grajqevcit, Gani Azemit, Avni Azemajt, Adnan Maxhunit, Gent Azemajt dhe Alban Becit.

Propozimi për inicimin e këmbimit të parcelës/ave të tokës me bashkëpronarët e cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit të Planit rregullues “Arbëria 3“, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës, 01. nr. 035-94056, dt. 04.05.2015, me destinim “Zonë e banimit miksi”. Parcela nr. 2955-7, shtrihet në zonë të planifikuar për ndërtim të lartë, ndërsa parcelat nr. 7179-1, shtrihet në infrastrukturë rrugore të planifikuar.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private, është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019), pasi që Komuna nuk ka pronë të veten për implementimin e projekteve të lartcekura.

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private, siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.



U dërgohet:

- Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe
- Qendrës për shërbime me qytetarë.

Kryetari i Komunës

Shpend Ahmeti

01-280/17

| | | |
|---|--|--|
|  | <p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina</p> | <p>PRISHTINA</p>  |
|---|--|--|

Në bazë të nenit 21 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, nenit 18 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-03 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 17, pika “d” të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimëve, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 350/02-0299521/18 dt. 21.12.2018, të pronarëve Salih Grajçevci, Gani Azemi, Avni Azemaj, Alban Beci, Gent Azemaj dhe Adnan Maxhuni nga Prishtina, rr. “Ahmet Krasniqi” Hyrja 6 nr. 37 në Prishtinë, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumë banesore dhe afariste, në kuadër të parcelës ndërtimore të bllokut urban “B5”, të tërësisë “Qendra” të Ndryshimi dhe Plotësimi i Planit Rregullues “Arbëria 3” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit në procedurë administrative, me datë 11.06.2019, merr këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I caktohen kushtet ndërtimore pronarëve Salih Grajçevci, Gani Azemi, Avni Azemaj, Alban Beci, Gent Azemaj dhe Adnan Maxhuni nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 350/02-0299521/18 dt. 21.12.2018, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumë banesore dhe afariste-“Ndërtesa”01”dhe ”02”, në kuadër të parcelës ndërtimore të bllokut urban “B5”, të tërësisë “Qendra” të Ndryshimit dhe Plotësimi të Planit Rregullues “Arbëria 3” në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 7179-1 ZK Prishtinë dhe me trajtim përmes këmbimit edhe të pjesëve të parcelës kadastrale nr. 2955-7 ZK Prishtinë, me pronar/posedues “P.SH. KK Prishtinë”.

II. Lokacioni për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, përfshihet në kuadër të Ndryshimi dhe Plotësimi i Planit Rregullues “Arbëria 3”, miratuar me Vendimin e Komunës së Prishtinës 01 nr. 035-94056 dt. 04.05.2015, ku sipas këtij plani, kjo hapësirë është e destinuar si “zonë e banimit miks”.

Pronarët me “Informim nga Plani Rregullues Ndryshimi dhe Plotësimi “Arbëria 3”, me referencë nr.1959 dt. 17.11.2018, të datës 19.11.2018, lëshuar përmes sistemit online nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, janë informuar për kriteret, parametrat urban dhe kushtet e ndërtimit për atë zonë.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit-parcelës kadastrale, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, janë:
 - nr. 7179-1.....S=3417 m².....Salih Grajçevci, Gani Azemi, Avni Azemaj, Alban Beci, Gent Azemaj dhe Adnan Maxhuni.....”arë e klasës 2”;
 - nr. 2955-7.....S=2139 m².....P.SH. KK Prishtinë.....”infrastrukturë-rrugë”;
- E drejta pronësore – juridike e parcelës kadastrale të lartcekur, është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Në kuadër të parcelës kadastrale të lartcekur, nuk ka ndërtime të ndërtuara-parcela është e zbrazët,
- Terreni ka pjerrtësi /disnivel nga drejtimi verilindje në jugperëndim, me disnivel ~3.50 m`;
- Qasja ekzistuese e parcelës kadastrale të lartcekur, është përmes rrugës lokale ekzistuese “Ferid Curri”, e cila është edhe rrugë e planifikuar e planit rregullues;

- Në hapësirën e përfshirë në diametër prej 50 m' ka ndërtesa ekzistuese, si: ndërtesa shumë banesore dhe shtëpi banimi, etj.;

IV. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/ projektit kryesor për rregullimin e hapësirës sipas gjendjes së planifikuar në kuadër të parcelës ndërtimore të kompleksit, e përfshirë në kuadër të bllokut urban "B5", të tërësisë "Qendra" të Ndryshimi dhe Plotësimi i Planit Rregullues "Arbëria 3" në Prishtinë, përcaktohen duke konsultuar, analizuar, si dhe mbështetur në dokumentet e planifikimit hapësinor, projekt propozimin e prezantuar, gjendjen ekzistuese të lokacionit dhe rregullativën ligjore në fuqi:

- Parcela ndërtimore, organizimi, gabariti, pozicionimi dhe etazhiteti i ndërtesave, qasja në kompleks si dhe raporti i ndërtesave me vijën rregulluese dhe ndërtimore, distancat në mes ndërtesave dhe nga kufiri i parcelës ndërtimore, rrugët dhe vendparkimet e planifikuara të kompleksit, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të planifikohen sipas kriterëve të planit rregullues urban dhe kriterëve të përcaktuara në pikat e këtij paragrafi, duke u bazuar në "Plani i lokacionit-"zgjdhja urbane", si dhe "Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga Ndryshimi dhe Plotësimi i Planit Rregullues "Arbëria 3" në Prishtinë, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01", bashkëngjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;

- Parcela kadastrale me sipërfaqen e trajtuar, në pjesën e bllokut urban "B5", për realizimin e kompleksit me ndërtesa shumë banesore dhe afariste, që përfshihet në ndërtim-parcelë ndërtimore, konkretisht pjesa e parcelës kadastrale, e trajtuar brenda vijës rregulluese, është:

- nr. 7179-1.....S=3029 m²;
- nr. 2955-7.....S=12+10=22 m²;

Sipërfaqe e përgjithshme e parcelës ndërtimore, brenda vijës rregulluese, është S=3051 m²;

- Parcela kadastrale me sipërfaqen e trajtuar, në pjesën e bllokut urban "B5", për realizimin e kompleksit me ndërtesa shumë banesore dhe afariste, që përfshihet në ndërtim-parcelë ndërtimore, konkretisht pjesa e parcelës kadastrale, e trajtuar jashtë vijës rregulluese, është:

- nr. 7179-1.....S=303+5+80=366 m²;

Sipërfaqja e përgjithshme e parcelave, jashtë vijës rregulluese, e trajtur sipas Vendimit 01 Nr. 400-660 dt.26.05.2008 të Krjetarit të Komunës së Prishtinës.....S=366 m²

- nr. 7179-1.....S=22 m²;

Sipërfaqja e përgjithshme e parcelave, jashtë vijës rregulluese, e propozuar për trajtim me këmbim, sipas Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.....S=22.00 m²

- Parcela kadastrale nr. 2955-7 ZK Prishtinë, me sipërfaqe të tërësishme prej S=2139 m² dhe me pronar/ posedues P.SH. KK Prishtinë, dhe trajtim në sipërfaqe prej S=10+12=22 m², përfshihet brenda vijës rregulluese të bllokut urban "B5", dhe e njëjta është propozuar nga pronarët dhe investitori që të këmbetet me pjesën e parcelës kadastrale nr. 7179-1 ZK Prishtinë, me sipërfaqe të përgjithshme S=22 m²;

- Parcela kadastrale nr. 2956-7 ZK Prishtinë, me sipërfaqe të tërësishme prej S=1631 m² dhe me pronar/posedues Nazmi Ahmeti dhe Shehide Kovaçi, me sipërfaqen prej S=5.0 m², përfshihet brenda vijës rregulluese të bllokut urban "B5", dhe e njëjta është nuk është trajtuar në këtë zgjidhje urbane;

- Me këto kushte ndërtimore në kuadër të kompleksit me ndërtesa shumë banesore dhe afariste, në bllokun urban "B5" të tërësisë "Qendra", planifikohet të ndërtohen ndërtesat shumë banesore dhe afariste, të organizuara në hyrje, me sipërfaqe ndërtimore mbi tokë dhe nën tokë, si në vijim:

Kompleksi me ndërtesë shumë banesore dhe afariste – Ndërtesa "A1" dhe "A2"

Ndërtesa "A1"

S=4108.00.00 m² /3010.00 m², mbi tokë+1098.00 m², nën tokë /,

Etazhitet: -B+P+5;

Ndërtesa "A2"

S=2847.00 m² / 2115.00 m², mbi tokë+732.00 m², nën tokë /,

Etazhitet: -B+P+5;

Sipërfaqja e përgjithshme: S=6955.00 m² / 5125.00 m², mbi tokë+1830.00 m², nën tokë /,

- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesave të kompleksit, të jetë për banim shumë banesor dhe afarizëm, dhe me hapësira përcjellëse, si: kthina teknike, depo dhe hapësira garazhesh etj. (sipas projekt propozimit);
- Etazhiteti maksimal për bllokun urban "B5", të tërësisë "Qendra" të Ndryshimi dhe Plotësimi i Planit Rregullues "Arbëria 3", është P+4 etazhe mbi tokë;
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelave kadastrale-parcelës ndërtimore (ISHP), konkretisht shfrytëzimi i parcelave brenda vijës rregulluese, për vendosjen e ndërtesës në bazën-gabaritin e përdhësës ose suteranit, është max. 30%, dhe kjo sipërfaqe është:

Kompleksi me ndërtesë shumë banesore dhe afariste – Ndërtesa "A1" dhe "A2"
 $S=3051 \times 0.3=915.30 \text{ m}^2$ / sipas PRRU /
 $S=912.00 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit /.
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore (ISHN), për vendosjen e ndërtesës në bazë - gabarit të bodrumit, është max.60%, bazuar në kriteret e planit rregullues, dhe kjo sipërfaqe është:

Kompleksi me ndërtesë shumë banesore dhe afariste – Ndërtesa "A1" dhe "A2"
 $S=3051 \times 0.6=1830.60 \text{ m}^2$ / sipas PRRU /,
 $S=1830.00 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit /.
- Koeficienti i minimal i shfrytëzimit të parcelës kadastrale-parcelës ndërtimore, destinuar për hapësira gjelbëruese (ISGJ) është min. 40%, me gjelbërim të lartë, të ultë, si dhe hapësira të organizuara për sport dhe rekreacion, dhe kjo sipërfaqe është:
 - **Kompleksi me ndërtesë shumë banesore dhe afariste – Ndërtesa "A1" dhe "A2"**
 $S=3051 \times 0.4=1220.40 \text{ m}^2$ / sipas PRRU /,
 $S=1220.40 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit /.
- Indeksi i sipërfaqeve të përgjithshme të ndërtimit (ISPN), sipas Ndryshimi dhe Plotësimi i Planit Rregullues "Arbëria 3", është max.1.5.
 Trajtimi i sipërfaqeve ndërtimore për etazhet ndërtimore do të bëhet – llogaritet, si në vijim: 100% për etazhet mbi kuotën ± 0.00 , 50% për etazhet me vëllim mbi 51% apo së paku njëra ballore mbi nivelin e tokës - *suteren*, dhe 0% për etazhet e nëntokës – *bodrum*, dhe kjo sipërfaqe është:

Kompleksi me ndërtesë shumë banesore dhe afariste – Ndërtesa "A1" dhe "A2"
 $S=3051 \times 1.5=4576.50 \text{ m}^2$ / sipas PRRU /,
 $S=5125.50 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit duke përfshirë edhe kompensimin dhe këmbimin /.
- Me aplikimin e Vendimit 01 Nr. 400-660 dt.26.05.2008 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për kompensimin/shpronësimin e pronës private, të planifikuar për interes publik, me koeficient të ndërtimit, do të mundësohet që sipërfaqja e parcelës ndërtimore (brenda vijës rregulluese) të shtohet deri në 20 % të sipërfaqes së përgjithshme të parcelës ndërtimore, dhe sipas kësaj, kjo sipërfaqe, përcaktuar në përqindje (%) është $S=366/3051=11.99 \%$. Sipas këtij kalkulimi, pronarët dhe investitori, për sipërfaqen e theksuar, do të kompensohen me sipërfaqen ndërtimore, llogaritur me koeficient të ndërtimit 1.5, $S=366 \times 1.5=549.00 \text{ m}^2$, ndërsa sipërfaqja e përgjithshme ndërtimore, e lejuar, do të jetë $S=4576.50+549.00=5125.50 \text{ m}^2$.
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt. 14.08.2016 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të kursimit dhe efijencës së energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Bazuar në kriteret e planit rregullues, distanca minimale e ndërtesës me kthina primare është $0.75 \times H$, kurse me kthina sekondare $0.25 \times H$. Me marrëveshje me fqinj kjo distancë mund të jetë edhe $0 + 0.25 \times H$. Distanca në mes të ndërtesave të një kompleksi duhet të jetë min. $1 \times H$;
- Ngritja e nivelit të përdhësës nga niveli i terrenit të jetë max. 1.20 m;
- Qasja në kompleksin me ndërtesa shumë banesore dhe afariste të jetë nga rrugët e planifikuara të planit rregullues urban, sipas Plani i situacionit - "zgjidhja urbane";
- Për çdo njësi banesore dhe çdo 40 m^2 të neto sipërfaqes së afarizmit, të planifikohet një vendparkim, në kuadër të ndërtesave apo kompleksit;
- Në kuadër të kompleksit të parashihen edhe vendparkimet e jashtme, rrugë të brendshme të kompleksit, si dhe shtigjet dhe trotuarët;

- Në kuadër të kompleksit të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
 - Arkitektura-dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efikasitetit të energjisë, dhe ti përshtatet ambientit për rreth.
- V. **Këmbimi** i pjesës së parcelës kadastrale nr. 2955-7 ZK Prishtinë, me sipërfaqe $S=10+11=22 \text{ m}^2$, në pronësi/posedim të P.SH. KK Prishtinë, me pjesën e parcelës kadastrale nr. 7971-1 ZK Matigan, me sipërfaqe $S=22 \text{ m}^2$, e shtrirë jashtë vijës rregulluese të bllokut urban, nga pronarët është propozuar të bëhet bazuar në Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për këmbimin e parcelave të lartcekura, sipas Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore dhe manualit të ndarjes, punuar nga gjeodeti i licencuar. Procedura e këmbimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e përkthyer në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e këmbimit do të realizohet, para aplikimit për leje ndërtimore në Drejtorinë e Pronës të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore, me kërkesë të pronarëve dhe investitorit, duke u bazuar në Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga Plani Rregullues në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01, punuar nga gjeometri i drejtorisë, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Mos zbatimi i kësaj procedure sipas këtij paragrafi, nga pronarët dhe investitori, për arsye të ndryshme, detyron Drejtorinë e Urbanizmit, të rishikojë kushtet ndërtimore - revokimin e tyre.

VI. **Kompensimi** me koeficient ndërtimi i pjesës së parcelës kadastrale nr. 7971-1 Z Prishtinë, me sipërfaqe $S=366 \text{ m}^2$, e përfshirë në hapësirë publike të planifikuar-rrugë, të realizohet si më poshtë:

Sipas kalkulimeve në paragrafin IV., parcela ndërtimore e kompleksit në kuadër të bllokut urban "B5" është me sipërfaqe prej $S=3051 \text{ m}^2$, kurse pjesa jashtë vijës rregulluese-hapësirë publike është $S=366 \text{ m}^2$, andaj bazuar në Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës 01 nr. 400-660 dt. 26.05.2008, kompensimi i pronës private, e përfshirë në hapësirë me interes publik, mund të realizohet me koeficient të ndërtimit për sipërfaqen deri në 20%, dhe sipas kësaj, përcaktuar në përqindje (%), është $S=366/3051 \times 100=11.99 \%$. Andaj, sipas kalkulimit me koeficient ndërtimi, pronarët dhe investitori, për sipërfaqen e theksuar, do të kompensohen me sipërfaqe ndërtimore të ndërtesës: $S=366 \times 1.5=549 \text{ m}^2$.

Kjo drejtori jep PËLQIM për kompensimin me koeficient ndërtimi të pjesës së parcelës kadastrale, bazuar në vendimet e lartcekura. Kjo procedurë e kompensimit me koeficient ndërtimi, do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për arritjen e marrëveshjes definitive, në mes të bashkëpronarëve të parcelës dhe Komunës së Prishtinës, konkretisht Drejtorisë së Pronës të Komunës së Prishtinës.

Sipërfaqet definitive të kompensimit me sipërfaqe ndërtimore të trajtohen pas këmbimit, ndarjes dhe bashkimit, dhe barazimit të sipërfaqeve të parcelave kadastrale, sipas paragrafit V, VII dhe VIII të këtij vendimi.

Mos zbatimi i kësaj procedure sipas këtij paragrafi, nga bashkëpronarët dhe investitori, për arsye të ndryshme, detyron Drejtorinë e Urbanizmit, të rishikojë sipërfaqet ndërtimore të ndërtesës shumë banesore dhe afariste, të përcaktuara me këtë vendim për caktimin e kushteve ndërtimore.

VII. **Ndarja/parcelimi** i parcelës kadastrale, nr. 7971-1 dhe 2955-7 ZK Prishtinë, do të realizohet sipas parcelës ndërtimore, e përcaktuar me vijën rregulluese të bllokut urban "B5", si dhe bazuar në Plani i situacionit-"zgjdhja urbane", dispozitën urbanistike, punuar nga kjo drejtori, dhe manualin e ndarjes të punuar nga gjeodeti i licencuar

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për ndarjen e parcelave kadastrale të lartcekura, sipas Planit të situacionit - "zgjdhja urbane" dhe "Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01", punuar nga kjo drejtori dhe manuali i ndarjes dhe bashkimit, punuar nga gjeodeti i licencuar. Procedura e ndarjes/parcelimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e ndarjes të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas vendimit të kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve dhe investitorit, duke u bazuar edhe në, Plani i situacionit - "zgjdhja urbane" dhe "Situacioni i parcelave

me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01”, punuar nga kjo drejtori dhe manualit të ndarjes, punuar nga gjeometri i licencuar, e të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

VIII. Bashkimi i parcelave dhe pjesëve të parcelave kadastrale, nr. 7971-1 dhe 2955-7 ZK Prishtinë, sipas parcelës ndërtimore dhe bazuar në Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga plani rregullues në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01, dhe manualin e bashkimit të parcelave, do të bëhet në një parcelë të vetme-parcelë ndërtimore.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për bashkimin e parcelave të lartcekura, sipas Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga plani Rregullues në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01. Procedura e bashkimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e përshkruar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e bashkimit të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore, me kërkesë të pronarëve dhe investitorit, duke u bazuar në Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga Planin Rregullues "Mati 1" në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01, punuar nga gjeodeti i drejtorisë, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

IX. Kyçja në infrastrukturë - për marrjen e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina" aplikimi do të bëhet nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, i dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) Mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin - adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për energji elektrike dhe ujësjellës).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos" - Ngrohtorja e Qytetit sh. dhe PTK-ja.

X. Dokumentacioni ndërtimor/projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinore, "Rregullore MMPH Nr. 03/2016 për normat minimale teknike për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi", bazuar në "Udhëzim Administrativ Nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara", normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale, dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin - planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m', me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin - planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë;
- Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera me kuota të shënuara, relative dhe absolute;

- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore - zejtare;
- Detajet e nevojshme në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit, me rrugë, shtigje, mobiliarin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit - llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionim dhe detaje të nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro – energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vendndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr. 035-174324 dt. 12.07.2016 e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;
- Elaboratin gjeomekanik në bazë të analizave në terrenit;

XI. Dokumentacioni ndërtimor - Elaborati për Masat e mbrojtëse nga zjarri hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e "Deklaratë" për Masat e mbrojtjes nga zjarri.

